



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8125.....

Tirane, date 15/12/2015

Drejtuar: Z. ORHAN GAZI CENGAVER
SHOQERIA "NIKOLLI - 2010" SHPK
RRUGA "SAMI FRASHERI", PRANE LSI,
RESTORANT – PICERI "MYSTIK"

TIRANE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1566 date 15.06.2012

I nderuar z. Cengaver,

Shoqëria "Nikolli - 2010" shpk është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1566 date 15.06.2012 për mineral kromi, ne objektin "Lufaj i Epërm" Bashkia Rrëshen, ne Qarkun Lezhe.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 10229 date 03.12.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.7899 date 04.12.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te nr.1566 date 15.06.2012 për mineral kromi, ne objektin "Lufaj i Epërm" Bashkia Rrëshen, ne Qarkun Lezhe, për arsye se është ndërprere puna pa njoftuar me përpara strukturat përgjegjëse, siç përcaktohet ne shkronjat "d", "dh" dhe "e" te nenit 18 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në gjuhën “c” të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1566 datë 15.06.2012 për mineral kromi, në objektin “Lufaj i Epërm” Bashkia Rrëshen, në Qarkun Lezhë**, që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1566 datë 15.06.2012 për mineral kromi, në objektin “Lufaj i Epërm” Bashkia Rrëshen, në Qarkun Lezhë.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitetet minerare.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKURI

